



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 15.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy kërkeses për ri-shqyrtim të datës 05.04.2024 të parashtruar nga Grup i OE MABCO CONSTRUCTIONS SH.P.K.; AAG PROJEKT; IMK - Industria Metalike E Kosovës SH.P.K. nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Grup i OE MABCO CONSTRUCTIONS SH.P.K.; AAG PROJEKT; IMK - Industria Metalike E Kosovës SH.P.K. e datës 05.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 02.04.2024 të publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 02.04.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i OE MABCO CONSTRUCTIONS SH.P.K.; AAG PROJEKT; IMK - Industria Metalike E Kosovës SH.P.K. me datën 05.04.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Ligji për Prokurim Publik i konsoliduar.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës;

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional;

Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik;

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë,

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve;

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Udhëzuesi për Prokurim publik 001/2023.

Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Pretendimet ankimore

Te nderuar,

Autoriteti kontraktues – Ministria e Shendetesise, me datën 02/04/2024 ka publikuar Formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK-se ku grupi i OE-ve ankues “Mabeo Construction” Sh.P.K., AAG Project & IMK” Sh.P.K. – Prishtine, sipas letres standarde e keni eliminuar ne mënyrë te kunderligjshme dhe atë me arsyetimin se:

- *“Tek aneksi 1, i DT-se është kërkuar qe OE duhet te dorëzon me ofertën e tij planin dinamik te detajuar duke plotësuar formen standarde te planit dinamik tes publikuar si dokument shtese max 30 muaj. Planin dinamik nuk e keni plotësuar si duhet, nuk e keni plotësuar ngjaf forma standarde siç është kërkuar dhe*
- *Nuk keni plotësuar kërkesen 1 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale për ISO certifikatat e kërkuara, mirëgojne ISO-te 9001, 14001 dhe 45001 për anëtarin e konzorciumit IMK Sh.P.K.”*

Grupi i OE-ve ankues “Mabeo Construction” Sh.P.K., AAG Project & IMK” Sh.P.K. – Prishtine, konsideron se arsyetimi i eliminimit te ofertës tone me arsyetien te tille, paraqet shkelje esenciale te dispozitave ligjore, rrjedhimisht eshte rekomanduar për dhënie te kontratës Operatori Ekonomik i cili ka ofertuar me oferte te përgjegjshme ne raport me kërkesat kualifikuese, prandaj ne afatin e parapare me nenin 108/A te LPP-se, paraqesim këtë:

Kërkesë për Rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1:

Sa i përket arsyetimit te pare te eliminimit, lidhur me planin dinamik, grupi i OE-ve ankues, ne oferte ka prezantuar planin dinamik te detajuar ashtu siç është kërkuar nga AK – Ministria e Shendetesise, përkatësisht, mosplotësimi i formes standarde ne asnje rrethane dhe me asnje dispozit ligjore nuk e ben ofertën e përgjegjshme.

Me ligj per Prokurim Publik ne fuqi dhe rregulla tjera te ndertimit qellimi i planit dinamik është perfundimi ne afatin e përcaktuar te aktiviteti punes. Plani dinamik i prezantuar nga grupi i OE-ve, ankues ne oferte, ka te pershkuara te gjitha fazat e realizimit te punes dhe sipas afatit te përcaktuar nga AK – Ministria e Shendetesise.

Rrjedhimisht, aplikimi i formes se aplikuar nga AK – MSH, sipas par. 3 te nenit 44 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, nuk është obliguese por si qellim ka vetëm ndihmen e OE-ve gjate pergaditjes se ofertave.

Par. 3 i nenit 44 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik parashef qe:

“Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.”

Pra sipas dispozites se sipër pershkuar forma standarde ka për qellim te ndihmoj operatorin

ekonomik dhe nuk ka për qëllim të obligoi, që të perdot të njejtën.

Sa i përket aplikimit të formës standarde lidhur me planin dinamik të realizimit të punëve, ekzistojnë edhe vendime të OSHP-se si dhe interpretime të KRPP-se, ku për këtë qeshtje është gjykuar ndryshe nga ju si AK. Ku të njejtat vendime dhe interpretime i gjëni në ueb faqet e instancave perkatëse.

Pretendimi ankimor 2:

Sa i përket arsyetimit të dytë të eliminimit ku është potencuar se anetari i grupit IMK, nuk ka prezantuar ISO certifikatat.

Ju si Autoritet Kontraktues edhe në arsyetim të eliminimit të ofertës tone keni potencuar se ISO certifikatat janë kërkuar tek Kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, mjedhimisht me dispozitat ligjore të LPP-se në fuqi, të njejtat kërkesa si burim kanë dispozitat ligjore nga neni 69 i Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht, kërkesat e tilla sipas paragrafit 4 të nenit 71, nuk janë obligative për secilin anetar veç e veç.

Neni 71, i LPP-se, përcakton:

"Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit."

Bazuar në dispoziten e lartepërmendur, për të eliminuar ofertën tone si të papërgjegjshme me të njejtin arsyetim, të njejtat certifikime ju si AK, ka qenë dashur t'i aplikoni të kërkesat e përshtatshmerisë profesionale dhe jo të kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional.

Megjithatë, grupi i OE-ve ankues në oferte ka prezantuar certifikime ekuivalente, dhe atë certifikatat: EN 1090 – 2; ISO 3834 – 2; ISO 9606 – 2; ISO 9712 – 2 dhe ISO 1473-2.

Neni 70 i Ligjit për Prokurim Publik shprehimisht përcakton që:

"Po që se AK kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura, me të cilat vërtetohet përputhshmeria e operatorit të OE-se me një numër të caktuar standartesh për sigurimin e cilësisë, AK do t'i referohet standardeve që bazohen në standarde vendore, evropiane apo nderkombetare. AK do t'i pranojë certifikatat e barasvlefshme të lëshuara nga çilido organ i certifikuar e barasvlefshme, pavarësisht nga vendi..."

ISO certifikatat e përkruara si më sipër janë ekuivalente dhe të barasvlefshme me ato të aplikuarat nga AK – MSH, në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë. Për më tepër, ju si AK përgjate procesit të vlerësimit të ofertave nuk keni respektuar dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-se, lidhur me nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, si dhe nenin 10 të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik ku nuk keni kërkuar kurrëfar sqarimi shtesë

apo plotesim te dokumentacionit.

Ne si OE, peraktesisht anetari i grupit per te cilin keni potencuar se nuk ka prezantuar ISO certifikata e tilla, i njejti me daten 02/02/2024, date kjo para hapjes se ofertave, ka kontraktuar organin certifikues ku me daten 04/04/2024, anetari i grupit eshte certifikuar me ISO certifikatat perkatese.

- Prove: Kontrata si dhe ISO certifikimet.

Për këtë çështje edhe KRPP ne ueb faqen e saj tek rubrika "Interpretimet Ligjore", te publikuar me datën 22/06/2023 ka dhene sqarimin ku trajtohet dhe sqarohet çështja e certifikatave për sigurimin e cilesise, ku potencohet:

"Si mjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001..., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohet në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit.

Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që gartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.3 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë njafton të sillet nga anëtarët e grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbushur nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit.

Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre."

Sipas dispozitave ligjore dhe opinionëve të KRPP-se, tek projektet që kanë të bëjnë me realizimin e kontratave të punës, AK ndaj operatoreve ekonomik nuk mund të aplikojë certifikata për sigurimin e cilësisë por mund të aplikojë certifikata të tilla ndaj produkteve përkatësisht për kontrata që kanë të bëjnë me realizim të shërbimeve dhe furnizimeve. Për më tepër, grupi i OE-ve ankues në oferte ka prezantuar edhe marreveshjen e krijimit të grupit dhe janë të ndara punët dhe përgjegjësit sipas veprimtarisë dhe specializimit përkatës.

Pretendimi ankimor 3:

Ju si AK, me rastin e ekzaminimit krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, keni shkelur në tërësi dispozitat ligjore dhe nuk keni argumentuar dhe prezantuar gjendjen faktike të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, pasi që në pikën 9.1 & 9.2

ne dosje te tenderit ne pozicionin 2 keni kerkuar:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Million Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimit për Kontratë. Në rast te konsorciumit, së paku 60% e punëve te përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Së paku njëri projekt te jetë spitalor me vlerë të madhe (kërkohet për liderin ne rast te grupit), ku të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj.

Nuk pranohen objektet individuale, ambulanta, projekte rrugore, ura, ujësjellës, kanalizime, e te ngjashme.

Ndërsa si dëshmi dokumentare keni kerkuar:

Një Listë të projekteve të realizuara - Original e vulosur dhe e nënshkruar.

Lista duhet t' i ketë këto te dhëna

- Titulli i kontratës.

- Investitori,

- Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e fillimit dhe te përfundimit të projektit,

- Vlerën e projektit. Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënet e lartcekura.

Për çdo projekt te realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t' i verifikoj transaksionet financiare).

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës, ne oferte ka prezantuar listën e projekteve te realizuara me vlere totale prej 30,901,003.51 euro, te perfshira gjithesej 25 projekte, dhe atë shumica nga projektet e pershkruara kane te bëjnë me objekte individuale, projekte rrugore, ujesjellsa, kanalizime dhe te ngjashme, perderisa ju si AK me kerkese kualifikuese keni përcaktuar se te njejtat projekte nuk do te pranohen. Ky veprim dhe propozimi për dhënie te kontratës me oferte te tille paraqet shkelje te parimit baze te prokurimit publik mos favorizimi – diskriminimi.

Ndërtimet dhe renovimet e stadioneve, ekzekutimi i puneve ne parkingje, ndertimi i parqeve, ndertimi i objekteve afariste dhe objekteve individuale, rehabilitimi dhe demolimi i objekteve tjera, furnizimi neper lagje te caktuara, instalimet elektrike dhe te nxemjeve qendrore, nuk kane te bejne me kerkesen kualifikuese prandaj, ju si AK – Zyra e Prokurimit dhe Komisioni vleresues i ofertave, me rekomandim për dhënie te kontratës me oferte te tille, keni shkelur parimet bazike te LPP-se, nga neni 7 ku keni favorizuar te njejtin OE.

Për me tepër, OE i rekomanduar nga ju si AK nuk ka prezantuar asnje projekt spitalor me vlere te madhe, ku te jene kryer punime lidhur me X-Ray, Gaz medicinal, ventilim,

klimatizim, dyer X-Ray automatike, siç është kërkuar në FDT.

Pretendimi ankimor 4:

Ju si AK në kërkesën 2, të pozicionit 8.1 & 8.2 tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare keni kërkuar:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje të pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit).

Ndërsa si dëshmi dokumentare keni kërkuar:

Dëshmia 2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhironlogari ose qasje të pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit).

Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vëltuar nga institucioni Bankar (në rastin e kredisë së pakushtezuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të projektit).

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk ka ofruar dëshmi përmes të cilave përmbushet kjo Kërkesë, përkatësisht nuk është prezantuar Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhironlogari apo qasje të pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion euro.

Pretendimi ankimor 5:

Ju si AK në pozicionin 4.6 dhe 4.7 tek Kërkesat mbi Mundësitë teknike dhe / ose profesionale keni kërkuar:

Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës - Tension i ulët dhe tension të lartë - së paku 5 vite përvojë pune profesionale;

Ndërsa si dëshmi dokumentare keni kërkuar:

Dëshmitë 4.3 – 4.10:

- Diplomën e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),*
- CV e nënshkruar nga vetë inxhinierët,*
- Kontratat ose marrëveshje të punës për këtë projekt (të noterizuara),*
- Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës,*
- Licenca me afat për gjeodetën ose kompaninë.*

Ne rast se OE ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani te licencuar për ofrimin e shërbimeve të gjeodezisë, OE duhet të ofroj kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e këtij projekti.

- Certifikata licenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, BM Group nuk ka prezentuar dëshmi lidhur me Inxhinierin e Elektroteknikes për tension të ulët apo tension të lartë.

Pretendimi ankimor 6:

Ju si AK në pozicionin 4.1, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional keni kërkuar:

Një Menaxher i Projektit - Inxhinier i dip. i Arkitekturës ose Ndërtimitarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve të punimeve ndërtimore (se paku një objekt spitalor).

Dëshmia 4.1.

- Vendimi për caktimin e Menaxherit të projektit,*
- Diploma e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),*
- CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri,*
- Kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt, (e noterizuar),*
- Referencat për përvojën sipas kërkesës.*

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, "BM Group", si Menaxher të Projektit ka prezentuar z. Ilir Meleqi, i cili sipas referencave të prezentuara në oferte, nuk figuron se e përmbush kërkesën kualifikuese të kërkuar nga ju si AK, përaktësisht sipas CV-së dhe referencave rezulton që i njëjti nuk ka menaxhuar asnjë objekt spitalor.

Pretendimi ankimor 7:

Në pozicionin 4 të Kërkesave teknike dhe profesionale, ju si AK keni kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me staf profesional të nevojshëm (min. 10 inxhinierë) për realizimin e projektit.

Ndërsa si dëshmi dokumentare keni kërkuar:

Lista e stafit profesional - origjinal e nënshkruar dhe vulosur.

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës sipas listës së prezentuar në oferte figuron se ka prezentuar dhe përshkruar gjithsej 9 Inxhinier, të cilët do të jenë pjesë e projektit. Ngjashëm, është vepruar edhe lidhur me stafin tjetër teknik ku ju si Autoritet kontraktues për gjithsej 12 udhëheqesit keni kërkuar "Kontrata të noterizuara ose marrëveshje", por për të cilat nuk figuron se të njëjtët janë caktuar në pozita udhëheqese. Rrjedhimisht, keni rekomanduar OE i cili nuk i plotëson kërkesat kualifikuese të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë, dhe si i tillë ka qenë dashur të eliminohet si

i papergjegjshem.

Pretendimi ankimor 8:

Autoriteti kontraktues – Ministria e Shendetesise, sa i përket ofertave tjera te cilat kane ofertuar me çmim me te ulet se oferta e grupit te OE-ve ankues, përveç arsytetimeve te eliminimit te pershkruara ne leter standarde, te njejtat oferta kane edhe mangesi tjera ku AK – Zyra e Prokurimit dhe Komisioni vleresues i ofertave nuk i ka ekzaminuar dhe krahasuar ofertat ne kuptim te dispozitave ligjore dhe ne kuptim te gjendjes faktike ne oferte, pasi qe disa nga ofertat kane mangesi tjera lidhur me kerkesat kualifikuese sa i përket stafit lye dhe stafit teknik, ku nuk janë prezantuar dëshmi dhe prova përmes te cilave mbulohet pervoja e punes, menaxhimi i projekteve dhe objekteve spitalore, nuk janë prezantuar CV dhe referenca ku konfirmohet se janë menaxhuar projekte te tilla dhe nuk janë prezantuar certifikime adekuate ndaj stafit tjetër si dhe nuk janë prezantuar referenca adekuate me kerkesen dhe natyren e projektit.

Perfundimisht, grupi i OE-ve ankues bazuar ne faktet, provat dhe dëshmitë e prezantuara me larte dhe atyre te bashkangjitura ne oferte, kërkojmë qe AK – Ministria e Shendetesise, zyra e Prokurimit te nxjerr ketë:

V E N D I M

- **TE APROVOHET** si e bazuar ne tërësi kerkesa për ri shqyrtim,
- **TE ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-se si i kunderligjshem,
- **TE KTHEHET** lënda ne Rivleresim, përkatësisht te formohet komision rivleresues profesional dhe i paanshem ndaj ofertuesve dhe te rekomandohet për dhënie te kontratës Grupi i OE-ve ankues "Mabeo Constructions" Sh.P.K. & co., përkatësisht te eliminohet oferta e OE "BM Group" si e papergjegjshme.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Sa i perket pretendimit ankimor 1, ku e kundershtoni arsyen e eliminimit per Planin Dinamik te ofruar, nuk pajtohem me kete pretendim dhe e konfirmojme arsyen e eliminimit te publikuar permes Njoftimit te dates 02.04.2024.

Nuk pajtohem me pretendimin referuar Par. 3 te nenit 44 te Rregullores nr. 001/2022 per PP, meqense ne kete rast te Aneksi 1 i DT është kërkuar ne menyre specifike qe:

OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar" duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese tek Dosja e Tenderit.

Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Plani dinamik duhet te jete konform normave dhe standardeve ndërtimore.

Plani dinamik bene pjese ne dokumentet teknike te projektit dhe plotesimi i tije eshte shume i rendesishem nga aspekti teknik dhe si i tille nuk mund te trajtohet ose anashkalohet si nje çeshtje formale administrative qe nuk ndikon ne projekt.

Ju sqarojme me detajisht arsyet se pse Plani dinamik i ofruar nga ana juaj eshte i pa pranueshem per AK:

1. Plani dinamik i AK i publikuar ne platforme si dokument shitesë tek Dosja e Tenderit, ka qene dokument i hartuar nga Njesia per Infrastruktura ne MSh, me te dhena te detajuara per plotesim te gjithe rrjedhes se puneve ne projekt. Ky plan i hartuar nga MSh ne formatin Exel ka te shenuar afatet kohore ne baza ditore – me ndarje ne baza ditore, qe te plani juaj nuk eshte e tille por eshte e shkallzuar ne periudha 2 mujore.

2. Plani dinamik i AK nder te tjera ka te shenuar edhe kete permbajtje:

VEREJTJE:

KOHEZGJATJA TE SHENOHE T SIPAS DITEVE KALENDARIKE DHE MBETET PERGJEGJESI E OPERATORIT EKONOMIK ZBATIMI I LIGJIT Nr. 03/L-212 TE PUNES, DUKE PERFSHIRE ORARIN E PUNES, SI DHE ANGAZHIMET NE DITE TE FUNDJAVES DHE DITE FESTASH

OPERATORI EKONOMIK NE FAZEN E KONKURIMIT I PLOTESON VETEM DY (2) KOLONAT E PLANIFIKIMIT (kolona C dhe D), KURSE KOLONAT E IMPLEMENTIMIT-ZBATIMIT (kolona E dh F) PLOTESOHEN GJATE PERMBUSHJES SE KONTRATES.

3. Plani dinamik i ofruar nga ana juaj ka mangesi edhe ne permbajtje, ku si me karakteristike mund ta veçojme pozicionin **Punimet përgatitore dhe shërbimet**, për te cilën ju e keni cekur se do te zgjasin 252 dite, me një vije te pa ndërprerë sa tere periudha e kryerjes se projektit, ndërkohë qe ne këtë kapitull përfshihen 10 pozicione te cilat punohen krejt ne fillim, me përjashtim te poz. A1.10 Trajnimi i stafit i cili behet krejt ne fund.

1	Punimet përgatitore dhe shërbimet
A.1.1	Inçizimi gjeodezik i lokacionit – Relevimi dhe pozicionimi i strukturave ndihmese te objektit.
A.1.2	Furnizimi dhe montimi i objekteve të përkohshme - zyreve (per kontraktorin, organin mbikqyres, investitorin), depove të përkohshme,toaletëve,etj për menaxhimin e punëve ndërtime, sipas specifikimit teknik.
A1.3	Demolimi dhe largimi I rrethojes egzistuese (te demtuar) dhe adaptimi I terenit per rrethojen e re. sipas specifikimit teknik.
A1.4	Furnizimi me material dhe rrethimi i punishtes, me gardh jo transparent me lartësi dhe të dhëna sipas specifikimit teknik.
A1.5	Qasja në Shërbimet komunale dhe kyçja e përkohshme në rrjetin elektrik, të ujësjellësit dhe kanalizimit gjatë periudhës së ekzekutimit të punimeve,sipas specifikimit teknik.
A1.6	Organizimi i punishtes, përfshirë shenjëzimin e nevojshëm të të gjitha hapësirave sipas rregullave për sigurine në punishte, ndermarrjen e masave per mbrojtjen nga zjarri etj.
A1.7	Furnizimi dhe montimi i tabelës informuese rreth projektit me dimensione 2.0x3.0m .
A1.8	Punimi i dokumentacionit përfundimtar teknik ("As Build"), sipas specifikimit teknik.
A1.9	Testimi i materialeve, pajisjeve, strukturat dhe sigurimi i cilësisë sipas specifikimit teknik.
A1.10	Trajnimi i stafit të përfituesit për operim me pajisje dhe sistemet e montuara,sipas specifikimit teknik.

Sa i perket pretendimit ankimor 2, ku e kundërshtoni arsyen e eliminimit për mungesë të ISO certifikatave për anëtarin e konsorciumit IMK, nuk pajtohemi me këtë pretendim dhe ju rikujtojmë se sipas Sqarimeve shtese të publikuara në platforme me datën 05.02.2024, ku qarte është specifikuar se:

Përgjigje 2:

ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001 Në rast të konsorciumit, kërkohet për të gjithë anëtarët e grupit.

Ndërsa sa i përket kërkesës për ISO 3834-2 certifikatë e cilësisë për saldimin e materialeve metalike, kjo kërkesë mund të plotësohet ose nga ofertuesit, ose me marrëveshje me ndonjë kompani që e posedon këtë kualifikim.

Kërkesa për ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001 obligative për gjithë partnerët e konzerciumit, kjo është e bazuar edhe në nenin 26 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku specifikohet se:

Neni 26

Grup i Operatorëve Ekonomik

26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikatë të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standartet përkatëse.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 3, se OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar kriterin rreth punëve të kryera në projekte të ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë, nuk pajtohemi me këtë pretendim, duke marrë parasysh se OE i rekomanduar ka prezantuar Listen e projekteve në total 30,901,003.51 euro, ku vetëm me UNOPS I ka mbi 4.7 milion euro, ...

Gjithashtu nuk pajtohemi rreth pretendimit për objekte individuale, projekte rrugore, ujsjellëse, kanalizime etj. Si duket nuk i kemi lexuar sqarimet shtese në procedurën tenderuese, andaj ju rikujtojmë se përmes Sqarimeve shtese të publikuara me datën 05.02.2024 është lehtësuar ky kriter, ku është specifikuar se "1. *Pranohen edhe investimet private (si investime në ndërtim të ndërtesave afaristo banesore). Pranohen objektet individuale, pranohen ambulancat.*"

Përmes Sqarimeve shtese të publikuara me datën 05.02.2024, është zbutur kriteri rreth referencave dhe është hequr pjesa e kriterit për objekt spitalor, faqe 5 sqarimi si në vijim:

Përgjigje 2: ...Sa i përket kërkesës " Së pakti njëri projekt të jetë spitalor me vlerë të madhe (kërkohet për liderin në rast të grupit), ku të jenë kryer punime lidhur me Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj."

Zbutet kjo kërkesë, hiqet termi projekt spitalor me vlerë të madhe dhe tani kërkohet:

Te dëshmohet së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 4, se OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar kërkesën për mbështetje bankare 4 milion euro, nuk pajtohemi me këtë pretendim, duke marrë parasysh se OE i rekomanduar ka dëshmuar mbështetje bankare të pa kushtezuar (limit të aprovuar 3.4 + 3 mil euro) në total prej 6.4 milion euro, shih dëshmitë:

Theksojme se kompania BM Group shpk, me nr. identifikues 810839251 është klient i bankës tonë Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Kemi diskutuar qëllimin e kompanisë në fjalë për mbështetje financiare sipas referencës "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK", nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

BM Group shpk, aktualisht është klient aktiv në bankën tonë me një limit të aprovuar prej EUR3,400,000.00 dhe banka është e hapur të përkrah çdo kërkesë të klientit bazuar në kriteret dhe procedurat e brendshme të bankës për kreditim për projektin: "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK", nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

Dëshirojme t'ju informojmë se banka merr në konsideratë me interes të veçant çdo kërkesë financiare që lidhet me qëllimin e përmendur më lartë.

Theksojmë se Kompania "BM GROUP SHPK", me numër identifikues 810839251, me pronar **Bedri Gllareva**, është klient i bankës tonë. Kemi diskutuar qëllimin e Kompanisë në fjalë për mbështetje financiare sipas Referencës: "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1"

"BM GROUP SHPK", aktualisht është klient aktiv në bankën tonë me një limit të aprovuar prej 3,000,000 EUR dhe banka është e hapur të përkrah çdo kërkesë të tij bazuar në politikat e matjes dhe menaxhimit të riskut lidhur me meshtetjen financiare bazuar Referencën "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1"

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 5, se OE i rekomanduar nuk e ka ofruar inxhinierin e elektroteknikës për tension të ulët dhe tension të lartë, nuk pajtohem me këtë pretendim. Si duket nuk i keni lexuar sqarimet shtese në procedurën tenderuese, andaj ju rikujtojmë se përmes Sqarimeve shtese të publikuara me datën 05.02.2024 është lehtësuar ky kriter, ku në faqe 6 është specifikuar se: "*HIQET Tension i lartë dhe Tension i ulët. Këto dy kritere reduktohen në vetëm një kriter Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, se paku 5 vite provojë pune profesionale.*"

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 6, se OE i rekomanduar nuk e përbushur kërkesën rreth menaxherit të projektit z. Ilir Meleqi, se nuk ka menaxhuar asnjë objekt spitalor, nuk pajtohem me këtë pretendim. Si duket nuk i keni lexuar sqarimet shtese në procedurën tenderuese, andaj ju rikujtojmë se përmes Sqarimeve shtese të publikuara me datën 05.02.2024 është lehtësuar ky kriter, ku në faqe 6 është specifikuar se:

Përgjigje 4.1. dhe 4.2 HIQET pjesa në fund të kërkesës (se paku një objekt spitalor).

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 7, se OE i rekomanduar nuk e përbushur kërkesën për 10 inxhinier, por ka ofruar 9 inxhinier, nuk pajtohem me këtë pretendim. Si duket nuk i keni lexuar sqarimet shtese në procedurën tenderuese, andaj ju rikujtojmë se përmes Sqarimeve shtese të publikuara me datën 05.02.2024 është lehtësuar ky kriter, ku në faqe 6 është specifikuar se: "*HIQET Tension i lartë dhe Tension i ulët. Këto dy kritere reduktohen në vetëm një kriter Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, se paku 5 vite provojë pune profesionale.*"

Sqarim: Meqenese nga dy inxh. e elektroteknikës kërkesat 4.6 dhe 4.7 janë reduktuar në vetëm një kriter, numri total i inxhinierëve të kërkuar është ulur nga 10 në 9 inxhinier.

Gjate vleresimit te ketij aktiviteti AK ka pasur parasysh nenin 1 te LPP-se Qellimin e aktivitetit per realizimin e projektit, duke e rekomanduar per kontrate OE sipas Kriterit te dhenies se kontrates Oferta Ekonomikisht me e favorshme, ku nese perlogariten Çmimi me i lire 90% dhe Garancioni I puneve te kryera 7 vite 10%, atehere oferta e rekomanduar eshte fituese edhe sikur te gjitha ofertat te ishin te pergjegjshme.

Mangësitë e vogla ne ofertën e OE te rekomanduar i konsiderojmë si devijime te vogla, konform nenit 59.4 te LPP-se.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Grup i OE MABCO CONSTRUCTIONS SH.P.K.; AAG PROJEKT; IMK - Industria Metalike E Kosovës SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit